

Njoftimi i përqendrimit me të cilin Telekom Serbia SHA Beograd Serbi synon të fitoj kontrollin mbi një pjesë të operacioneve afariste të KABLOVSKA DISTRIBUCIJA SURÇIN SHPK BEOGRAD - Surçin Serbi

(lënda nr. 08-138/2022)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 13.10.2022, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës pranoi njoftimin e përqendrimit me të cilin Telekom Serbia SHA Beograd Serbi, me seli në rr. Takovska nr. 2 Beograd, Serbi synon të fitoj kontrollin mbi një pjesë të operacioneve afariste të KABLOVSKA DISTRIBUCIJA SURÇIN SHPK BEOGRAD – Surçin Serbi, me seli në rr. Vojvogjanska nr. 109, Beograd-Surçin, Serbi.

Telekom Serbia SHA Beograd Serbi është operator për shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik, i regjistruar për telekomunikacion kabllor.

Telekom Serbia SHA Beograd Serbia ka një shoqëri të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup me seli në rr Maksim Gorki 11/1-3, Shkup, me objekt operimi:telekomunikacionet me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimeve satelitore dhe ritransmetimin e programeve dhe shërbimeve televizive.

KABLOVSKA DISTRIBUCIJA SURÇIN SHPK BEOGRAD - Surçin Serbi është një operator për shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik, i regjistruar për telekomunikacionet kabllore dhe ofron shërbime interneti dhe shërbime të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike.

KABLOVSKA DISTRIBUCIJA SURÇIN SHPK BEOGRAD - Surçin Serbi nuk ka shoqëri të varura dhe nuk gjeneron të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për qëllimet e Njoftimit, tregu relevant i prodhimeve mund të përkufizohet si treg me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes në internet me brez të gjerë dhe treg me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike, ndërsa tregu relevant gjeografik është territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.10. 2022

Shkup